



Universiteti i Prizrenit Universität Prizren Prizren Üniversitesi "UKSHIN HOTI" FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE FAKULTET KOMPJUTERSKIH NAUKA BILGISAYAR BİLİMLERİ FAKULTESİ	
Pranuar me dt.	03. 11. 2022
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
429	388/22

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: ëëë.uni-prizren.com

Nr. i ref. - 388/22 Prizren, më 03/11/2022

Datë:	03.11.2022
Subjekti:	KONKURS

KONKURS PËR PUNË PRAKTIKE DHE TRAJNIME NË ITP

Bazuar në vendimin Këshillit Drejtues me nr.prot.01-233 të datës 06.06.2022 Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për punë praktike për studentët e FSHK-së, shpall konkurs për punë praktike dhe trajnime në ITP.

Menaxhmenti i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në përpjekjen e vazhdueshme për të siguruar punë praktike për studentët prezanton **Programin për Punë Praktike dhe Trajnime** në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve (ITP) Prizren.

Programi përkrahët nga Projekti i GIZ-it për themelimin e Qendrës për Transformim Dixhital në ITP të financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ). Ky program është në kuadër të bashkëpunimit me Projektin e GIZ-it për të shndërruar Qendrën për Transformim Dixhital nga një projekt në një konsorcium të anëtarëve dhe partnerëve, pjesë e të cilit do të jetë edhe Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren.

1. Punë praktike

Numri i studentëve: 20

Kohëzgjatja e punës praktike: 3muaj me mundësi vazhdimi edhe për 3 muaj

Rroga minimumi 200€ me financimin si vijon: 80 € GIZ, 80 € UPZ dhe minimum 40€ kompania.

2. Trajnime në ITP

Deri 10 student

Bursë deri 500€ për çdo trajnim që ofrohet për shkathtësi digjitale në ITP nga Projekti i GIZ-it Qendra e Transformimit Dixhital; minimum 20% kontribut nga vet studentët.

3. Procedura e përzgjedhjes së studentëve

Kushtet për punë praktike do jenë: nota mesatare, të jenë në vitin e dytë ose të tretë të studimit por përparësi do ju jepet studentëve të vitit të fundit të studimit dhe të jenë student aktiv në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike.

Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit:

1. Letër motivimi ku do specifikohet arsyeja pse dëshironi të ndjekni punën praktike apo trajnimin
2. CV
3. Certifikata e notave
4. Certifikata e lindjes
5. Dëshmi për njohjen e gjuhës angleze

Pas përfundimit të thirrjes publike do krijohet lista me kandidatët që plotësojnë kushtet bazike dhe do organizohet test në fushat për të cilat janë pozitat për punë praktike. Kandidatët me më shumë pikë në test do propozohen për pozitat për punë praktike. Me kandidatët e përzgjedhur do realizohet edhe intervista.

Fakulteti do të krijoj listën me studentët që do jenë në pritje për punë praktike dhe në bazë të kërkesave që vinë nga kompanitë e lokalizuara në ITP do dërgohen studentët përkatës.

Nga kjo ofertë nuk mund të përfitojnë kompanitë që nuk ndodhen në lokacionet e ITP Prizren.

Kohëzgjatja e konkursit 14 ditë nga data e shpalljes së saj në ueb faqen e Universitetit gjegjësisht deri më 16.11.2022. Dorëzimi i dokumenteve bëhet te Sekretarja e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike.

Pas përfundimit të afatit të konkursit publik do formohet nga Këshilli i Fakultetit komisioni i cili do bëjë përzgjedhjen e 20 kandidatëve për punë praktike dhe 10 kandidatëve për trajnime.

Provimi selektues do mbahet më 17.11.2022 dhe shpallja e rezultateve do bëhet deri më 18.11.2022.

Sqarim: Listat e studentëve të përzgjedhur do të dorëzohen në ITP dhe sipas nevojës së bizneseve do thirren studentët për punë praktike, kurse për trajnime do ofrohet nga ITP trajnimet aktive dhe studentët do zgjedhin ku dëshirojnë të ndjekin trajnimin. Puna praktike dhe trajnimet të gjitha janë në fushën e shkencave kompjuterike.

Nuk lejohet i njëjti student të aplikoj edhe për punë praktike edhe për trajnime.

Vërejtje: Me aplikimin në këtë program, studentët pajtohen që të dhënat e tyre të ndahen me Projektin e GIZ-it si dhe kompanitë që operojnë në ITP Prizren.

Kryesuesi i Këshillit/Dekan
Prof.Asoc.Dr.Ercan Canhasi

